



MISIONI SHQIPTAR

E Lumja Nënë Tereza

Blessed Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe 647 558 9382
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 12:30 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

BESNIKERIA


16 Nentor 2014



Në atë kohë, Jezusi u tregoi nxënësve të vet këtë shëmbëlltyrë: “Një njeri kur deshi të niset për dhe të largët, i thirri shërbëtorët e vet e ua dorëzoi pasuritë e veta. Njërit i dha pesë talenta, tjetrit dy, e të tretit vetëm një: secili sipas zotësisë së tij, e u nis për udhëtim. Menjëherë ai që mori pesë talenta u çua dhe i shtiu në punë e me ta fitoi edhe pesë tjerë. Po ashtu edhe ai që mori dy talenta, fitoi edhe dy tjerë. Kurse ai që mori vetëm një, shkoi, çeli një gropë në dhe, dhe e fshehi paranë e zotërisë së vet. Pas një kohe të gjatë, u kthye zotëria i atyre shërbëtorëve dhe kërkoi llogari prej tyre. E si doli para ai që kishte marrë pesë talenta, i qiti përpara edhe pesë tjerë e tha: ‘Zotëri, ti më pate dhënë pesë talenta, ja, edhe pesë tjerë që i fitova.’ I përgjigji zotëria i tij: ‘Të lumtë, shërbëtor i mirë e besnik! Pse u dëftove besnik në sende të vogla, do të bëj të parë mbi pasuri të mëdha: hyr në gëzimin e zotërisë tënd!’ U afrua pastaj edhe ai që kishte marrë dy talenta e tha: ‘Zotëri, ti më pate dhënë dy talenta, ja, edhe dy tjerë që i fitova.’ I përgjigji zotëria i tij: ‘Të lumtë, shërbëtor i mirë e besnik! Pse u dëftove besnik në sende të vogla, do të bëj të parë mbi pasuri të mëdha: hyr në gëzimin e zotërisë tënd!’ Kur u afrua ai që kishte marrë vetëm një talent, tha: ‘Zotëri, duke të njohur se je njeri i ashpër, se korr ku nuk mbolle e mbledh ku nuk hodhe, u frikësova e shkova dhe e fsheha talentin tënd në dhe: ja tani gjënë tënde!’ Zotëria i tij i përgjigji me këto fjalë: ‘Shërbëtor i keq dhe përtac! E ke ditur se korr ku s’mbolla, mbledh ku nuk hodha, prandaj të është dashur ta shtish paranë time në bankë e në kthimin tim kisha marrë gjënë time me kamatë. Prandaj merrjani këtij talentin e jepjani atij që ka dhjetë talenta! Sepse atij që ka do t’i jepet më, e do të ketë me shumicë; e atij që s’ka do t’i merret edhe ajo pakicë që ka! E shërbëtorin e pavlefshëm qiteni përjashta në terr, ku do të jetë vaj dhe kërcëllim dhëmbësh!’” Mt 25, 14-30

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12:30 te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: www.ourladyofmm.com ose kunsulto harten e ketushme.



Kalendari liturgjik...

- 17 Nentor Shen Elizabeta e Hungarise
18 Nentor Kushtimi i Bazilikës së
Shen Pjetrit dhe Palit
21 Nentor Kushtimi i Zojës
22 Nentor Shen Çeçilia
23 Nentor Krishti Mbret

28 Nentor, Party per Festen e Pavaresise...

Me **28 nentor, festa e Flamurit**. Te salla e kishes ne Browns Line, Darke me muzike live: me kengetaret Gezim Nika, Mirela Tafaj te shoqeruar nga Ditar Sherifi ne tastiere.

Per ticktes kontakto:

Luigj Narkaj 647.241.3060

Gjovalin Selmani 647.500.3875

Nik Biçi 647.309.0592

Arben Toma 647.887.9058

Bekimi i shtëpisë dhe i familjes...

Kush deshiron ti bekohet shtëpia dhe familja te kontaktoje me famullitarin ne numrat e Misionit Katolik Shqiptar, per te koordinuar ditën dhe orarin.

Hakun e Kishes per vitin 2014

e ka dhene Pal Rransburgaj:

Agron	Markaj	Edmond	Kacorri
Aleks	Coku	Eduard	Shkreli
Alfred	Shllaku	Erion	Tase
Altin	Miri	Flobenc	Shkalla
Angjelin	Kaçaj	Gac	Gjoka
Anton	Brunga	Gezim	Lanazi
Anton	Malaj	Gjergj	Gjinaj
Anton	Tinaj	Gjergj	Nikolla
Arben	Marku	Ilir	Gjokaj
Arben	Toma	Ladi	Lumaj
Arben	Pepa	Lek	Selmani
Arben	Therqaj	Lekë	Tarazhi
Ardian	Preçetaj	Lekë	Kapllaj
Arjana	Nati	Leks	Dragu
Astrit	Simeqi	Linda	Kalavaci
Aurel	Vata	Luigj	Narkaj
Beniamin	Hasko	Luk	Gjolaj
Dod	Ndreu	Luvigj	Lallinaj

Marash	Martinaj	Prek	Spaqi
Marin	Muzhani	Prek	Kaçaj
Mario	Martini	Preke	Gjonaj
Mark	Shkreli	Roza	Kalaj
Martin	Pjetri	Rrok	Gjoni
Martin	Vuktilaj	Sander	Kosmaci
Mhill	Ftoni	Sokol	Ujka
Ndok	Macaj	Sokol	Gashaj
Ndue	Cacaj	Tom	Uljaj
Nik	Biçi	Tome	Ivanaj
Nush	Kacaj	Ton	Vocaj
Nush	Dokaj	Valmir	Gjinaj
Pal	Rransburgaj	Vasel	Dreshaj
Paulin	Lukani	Vaso	Gjuravcaj
Paulin	Marku	Viktor	Pleti
Petrit	Ujka	Viktor	Gjokaj
Pjerin	Kalaj	Vitor	Mernacaj
Pjeter & Bep	Dreshaj	Vladimir	Doda
Prek	Frani	Zef	Deklaj
Prek	Lekaj	Zef	Lulaj

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

Per Hakun e Kishes: Vini re...

Sikur eshte caktuar me vendim te shumices se anetareve **Haku Vjetor i Kishes** eshte 500 dollare dhe mund te jipet ne cash, check ose me credit card (shih faqen website misioninenetereza.com Donate Now for Blessed Mother Teresa Mission), **ne nje shume te vetme ose pjese pjese gjate vitit. Ata te cilet per arsye te ndryshme jane ne veshtiresi te kontaktojne drejperdrejt me famullitarin.**

Papa Françesku: t'u jepen fëmijëve shembuj feje, jo fjalë



Për t'ua transmetuar fenë fëmijëve e të rinjve të sotëm e për t'i ndihmuar të provojnë përvojën e vërtetësisë e të dashurisë, të rriturit duhet t'u japin më shumë shembuj, sesa fjalë. E pohoi Papa Françesku gjatë homelisë së Meshës, kremtuar në Shtëpinë e Shën Martës, në praninë e një grupi të madh fëmijësh e adoleshentësh të një famullie romake. Si mund t'u përçohet feja të lindurve në epokën dixhitale? Me mënyrën, e cila mund të bëjë më shumë përshtypje mbi ata, që jetojnë vazhdimisht të nxitur nga figura: me shembull. Ditën kur bankat e Kapelës së Shën Martës të krijojnë përshtypjen e një DBR-je të vogël, me grupin e madh të fëmijëve të njërës nga famullitë romake, që pas ndrojtjes fillestare, krijojnë një atmosferë plot gjallëri, Françesku nis e u flet si katekist e, njëherësh, si formues katekistësh.

Të duhet sikur është “Mesha e fëmijëve”, thotë, e duke i shikuar fëmijët, vijon: është si të shikosh një premtim! Si të shikosh botën, që do të vijë. Po ardhmërisë sonë, pyet Papa, çfarë do t'i lëmë?": **"A e mësojmë atë, që dëgjuam në Leximin e parë: të ecim në dashuri e vërtetësi? Apo e mësojmë me fjalë, nësa jeta jonë shkon në një drejtim tjetër? Po ne kemi përgjegjësi për fëmijët! I krishteri duhet të kujdeset për fëmijët, për të vegjlit, e t'ua përcjellë fenë, t'ua përcjellë atë që jeton, që e ka në zemër. Nuk mund t'i harrojmë filizat e rinj, në rritje".** Gjithçka, pohoi Papa Françesku, varet nga qëndrimi i drejtë, që duhet mbajtur ndaj fëmijëve. E si sillem unë me ta? - pyeti akoma Papa. - Sillem si vëlla, si atë, si nënë, si motër, që e bën fëmijën të rritet, apo sjellja ime është e akullt: "ata rriten, unë shikoj jetën time...?": **"Të gjithë kemi përgjegjësi të japim ç'kemi më të mirë, e gjëja më e mirë që kemi, është feja: duhet t'ua japim, e t'ua japim me shembull! Me fjalë s'vlen gjë, me fjalë.... Sot fjalët nuk duhen gjë! Në këtë botë figurash, të gjithë fëmijët e kanë telefoninin e fjalët nuk u shërbejnë... Shembulli! Shembulli! Ç'u jap atyre?".** Në këtë ças nis dialogu. Papa fillon t'i pyesë fëmijët pse janë aty, në Meshë, e ndonjëri merr guximin e i gjegjet: "Për t'ju parë Juve?". Papa Françesku ia kthen: "Edhe mua më pëlqen t'ju shikoj" e, më pas, i pyet nëse e kanë marrë Kungimin e Parë e Krezmimin e u kujton të gjithëve se Pagëzimi hap portën e jetës së krishterë e, menjëherë pas, nis një udhë, që vijon gjithë jetën. Rruga e përshkruar në fragmentin e Letrës së Gjonit, dëgjuar pak më parë: "Të ecësh në vërtetësi e në dashuri". Pastaj, vijoi Papa, do të arrijmë tek sakramentet e tjera, si martesë. Por këtë udhë, vijoi të shpjegojë Ati i Shenjtë, duhet të dish ta përshkohësh e ta jetosh, ta jetosh me Jezusin": **"Në këto Sakramente – ju pyes – lutja a është Sakrament? ... Fort!.. Jo! Është e vërtetë, jo! Lutja nuk është Sakrament, por ne duhet të lutemi. Nuk e dini se duhet të lutemi? Ja, pra, mirë... Po! T'i lutemi Zotit, t'i lutemi Jezusit, t'i lutemi Zojës, që të na ndihmojnë në këtë udhë të së vërtetës e të dashurisë. E kuptuat? Erdhët për të më parë, kush nga ju e tha këtë? Ti? Është e vërtetë. Po dhe për të parë Jezusin. Dakord? Apo e lëmë mënjandë Jezusin? (fëmijët: 'Jo!'). Tani do të vijë Jezusi mbi elter. E do ta shikojmë të gjithë! Është Jezusi! Në këtë çast duhet t'i lutemi Jezusit të na mësojë të ecim në vërtetësi e dashuri. Ta themi së bashku? (gjithë bashkë) 'Të ecim në vërtetësi e dashuri'".**

Lutje per dike qe ndodhet ne Purgator...

Jezus i ëmbël, i gjunjësuar te këmbët e tua, po t'i ofroj veprat dhe fljimet e mia për Shpirtin të Purgatorit, të cilët Ti i do aq shumë. Dëshiroj që t'u ndihmoj që sa më parë të dalin prej vuajtjeve të tmerrshme që pësojnë e të vijnë te Ti, që aq shumë të dëshirojnë sikurse edhe ti aq shumë i do që t'i kesh të lumtur në shoqërinë tënde. Prano këtë dhuratë të varfër të dashurisë time, mbështille me hirin tënd të shenjtë,



Prayer of Mother Teresa



DEAR JESUS, help me to spread Thy fragrance everywhere I go. Flood my soul with Thy spirit and love. Penetrate and possess my whole being so utterly that all my life may only be a radiance of Thine. Shine through me and be so in me that every soul I come in contact with may feel Thy presence in my soul. Let them look up and see no longer me but only Jesus. Stay with me and then I shall begin to shine as you shine, so to shine as to be a light to others.

që dhurata ime të jetë efikase që këta Shpirta të bëhen ndërmjetësit e mi te Ti, o Shpëtimtar i mëshirshëm i shpirtave tanë, denjohu që ta pranosh lutjen time të cilën po ta drejtoj, për të gjithë të vdekurit, sidomos për ata që i kam më të afërm sipas gjakut ose lidhjeve shpirtërore. Në qoftë se ende gjenden në burgun në të cilin pastrohen, jepua sa më parë paqen dhe pushimin e pasosur, duke i pranuar si shpërblim për mëkatet e tyre fljimet dhe veprat që po t'i paraqesim për ta. Ti që jeton e mbretëron në

shekuj të shekujve. Amen!

LUTJA KUSHTUAR VIKTIMAVE TË DIKTATURËS KOMUNISTE

Lutja është formuluar nga Drejtësi dhe Paqe, Shkodër dhe është miratuar nga Imzot Angelo Massafra

*Të Lutemi o Zot
Sot ne këtë ditë simbolike
Në këtë vend dhimbjesh
Për ata të cilëve jeta u humbi
Në qelitë e ftohta
Mes lotësh e lutjesh të psherëtira nën zë
Lutemi për ata që u gllabëruan nga galeritë
Në punë skllavëruese
Me të vetmin shpërblim, bukë e ujë
Lutemi edhe për ata që nuk patën një vend të denjë
ku të prehen
Që u groposën si sende në këto shpate
Me një shishe në gjoks e një numër mbi kokë
Lutemi të kene gjetur paqen
Pranë teje, në amshim
Lutemi edhe për ata që mbijetuan
Të sfilatur, të tjetërsuar ne trup e shpirt
Të harruar e të përbuzur
Të lutemi hidh një rreze shprese
në vitet e tyre të fundit
Që pa pengje t'i mbyllin sytë
Lutemi edhe për shpirtat e atyre
Që nga djalli u mashtruan
dhe munduan vëllezërit e motrat e tyre
të pafajshëm
Lutemi edhe për ata*

Që lakmia u errësoi sytë
 E për përfitime boshe
 Lëshuan akuza e dëshmi të rreme
 Dhe u vodhën jetën vëllezërve e motrave të tyre
 Lutemi edhe për ata
 Të lëkundurit e të dobët
 Që jetuan me frikë në zemër
 E që për të shpëtuar veten
 Fundosën të tjerët
 Lutemi që në çastet e tyre të fundit
 Të kenë gjetur pendesën
 Që barra e mëkateve
 Të mos u rëndojë shpirtin në amshim
 Lutemi që çfarë ndodhi
 Kurrë më të mos përsëritet
 Po ashtu te Lutemi o Zot
 të na japësh urti, forcë dhe guxim
 Ta mbajmë të gjallë kujtimin e tyre
 E të ecim pa u ndalur përpara
 Në shtigjet e vështira të pajtimit. Amen!

Rocco C Lofranco LLB

The Madison Centre
 4950 Yonge Street Suite 600
 Toronto ON M2N 6K1

416 223 8333

Toronto • Scarborough • Mississauga • Brampton



LOFRANCO CORRIERO
 PERSONAL INJURY LAWYERS

KODRA

TM



Produkte Shqiptare!
 Prodhuar dhe importuar nga Shqiperia.

- Fergese
- Reçel fiku, pjeshke, kumbulle, qershie
- Marinade Speci, kastravec, lakre
- Specia te pjekur
- Specia djeges
- Panxhar i kuq
- Komposto kumbulle
- Uje Mineral Tepelene
- Coffee Skenderbeu



www.kodra.org

Radio Maria!
 Degjoje drejtpërdrejt ne
www.radiomaria.al

Sutton
 SUTTON WEST REALTY INC., BROKERAGE

Miranda Bimo
 Sales Representative

Bus: 416.240.1000
 Cell: 647.294.8826
 Fax: 416.240.1603

300-5415 Dundas St. W.
 Toronto ON. M9B 1B5

mirandabimo@gmail.com

Independently Owned and Operated

Violeta Selmanaj, Broker
Tony Selmanaj, Sales Representative

Per Shitje, Blerje, Qera Shitje, Condo A Po
 Biznese Lutemi Na Kontaktoni (Shume Vite
 Eksperience Ne Toronto Dhe Rrethina)

In House Mortgage Broker 25 Years
 Experience Special Rates Through
 Violeta and Tony Selmanaj For Fully
 Qualified Applicants.

* Call for Details

Direct (416) 553-5044
 Office: (905) 279-8300
 Email: vselmanaj@trebnet.com

ROYAL LEPAGE Realty Centre, Brokerage
 2180 Hurontario Street Mississauga, ON L5B 1M8

Kramer's Bar & Grill
 1915 Yonge St Toronto
Per Festa Private
 Kontakto Arben Toma
 Tel : 647-887-9058

BEQIRI
PROFESSIONAL CORPORATION

Ylli BEQIRI CPA.CGA

Tel: 416-854-9156
 Fax: 1-888-838-7736

974 The Queensway,
 Toronto ON M8Z 1P6

ybeqiri@sympatico.ca
www.beqiriaccounting.com